

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues Afrim Shala, me sekretaren juridike Fikrete Destani, në çështjen penale ndaj të pandehurit N. C. nga fshati Ll., Komuna e Gj., të cilën sipas autorizimit e mbron avokati G. A., nga Gj., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës,<sup>1</sup> sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.I.nr.25/2014, e datës 20.01.2014, të cilën e përfaqësonte prokurori Agron Uka, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 9 shkurt 2016, mori dhe publikisht shpalli, si dhe në këtë datë e përpiloi me shkrim këtë :

## AKTGJYKIM

I pandehuri N. C. nga babai I. dhe e nëna M., e lindur H., i lindur më ... , në Gj., tani me vendbanim në fshatin Ll., Komuna e Gj., shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i gjendjes së mesme ekonomike, nuk ka qenë e dënuar më parë për vepra tjera penale,

## ËSHTË FAJTOR

Sepse në kohë të pa vërtetuar më parë, i pandehuri pa autorizim (pa dokument valid), ka poseduar dhe mbajtur në pronësi armë të zjarrit dhe atë një revole të kalibrit ... mm, të tipit ..., edhe pse i njëjti e ka ditur se për këtë armë duhet të posedojë leje valide për bartjen-posedimin e të njëjtës, ashtu që me datën ..., rreth orës ... minuta, në Gjilan, në kafiterinë "...", gjatë kontrollimit nga ana e zyrtarëve policor, tek i pandehuri kanë gjetur këtë armë, të cilën edhe e sekuestrojnë,

- me këtë ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK.

Andaj, kryetari i trupit gjykues në bazë dispozitave të lartcekura ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 43, 46, 73 dhe 76 të KPRK, si dhe neneve 247 dhe 365 të Kodit të Procedurës Penale,<sup>2</sup> të pandehurit i shqipton :

## DËNIM ME GJOBË

<sup>1</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejshëm KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

<sup>2</sup> Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejshëm KPP), nr.04/L-123, i datës 13.12.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

Ashtu që të pandehurit N. C. i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 400 € (katërqind Euro), të cilin dënim i pandehuri, do ta paguajë në afat prej 3 (tre) muajve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që 1 (një) ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) Euro të dënimit me gjobë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e të pandehurit, në vend të shqiptimit të dënimit me burgim, ta zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, ashtu që 8 (tetë) orë të punës në dobi të përgjithshme do të llogariten me 20 (njëzet) Euro të dënimit me gjobë.

Konfiskohet arma e zjarrit – revolva e kalibrit ... mm, e tipit ... .

Detyrohet i pandehuri N. C. që ta paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej 25 Euro, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

## ARSYETIMI

### 1. Ecuria e procedurës

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë e lartcekur ndaj të pandehurit N. C. nga fshati Ll., Komuna e Gj., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK.

Pas ngritjes së aktakuzës, në Gjykatë është dorëzuar edhe një marrëveshje për pranimin e fajësisë e lidhur në mes të Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, në njërën anë dhe të pandehurit N. C. dhe mbrojtësit të saj, avokatit G. A., nga Gj., në anën tjetër. Sipas kësaj marrëveshje, kësaj Gjykate, i është rekomanduar që ndaj të pandehurit N. C. për shkak të kryerjes së veprës penale të lartcekur t'i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 400 € (katërqind Euro).

### 2. Vlerësimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, të mbajtur më datën 09.02.2016, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësit të pandehurit, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pas konsultimeve të mjaftueshme, me mbrojtësin e tij, avokatin G. A. se i pandehuri nuk ka qenë e detyruar ose e shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përbënë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

### 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, kryetari i trupit gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

- se i pandehuri N. C. me dashje e ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

### 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 374 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se formën themelore të veprës penale kontrollon ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet. Kryetari i trupit gjykues, e ka shpallur fajtor të pandehurën N. C. për shkak të veprës penale mbajtëja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK, ngase veprimet e të njejtës i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njejtën është edhe penalisht përgjegjëse. Kjo për faktin se siç e ka pranuar edhe vetë i pandehuri, që pa autorizim ka siguruar dhe mbajtë në pronësi armën e zjarrit të lartcekur, e cila i është sekuestruar nga ana e zyrtarëve policor.

#### 5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Kryetari i trupit gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit, ka vlerësuar se duhet të aprovet rekomandimi i paraqitur në marrëveshjen për pranimin e fajësisë që ndaj të pandehurit N. C. të shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 400 € (katërqind Euro), ngase ka vlerësuar se duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e shënuara më poshtë, ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurit, kryetari i trupit gjykues i ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenet 73 dhe 74 të KPRK. Kështu, si rrethana lehtësuese, është fakti se i pandehuri ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë me Prokurorinë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda. Gjithashtu, si rrethana lehtësuese, kryetari i trupit gjykues e ka marrë për bazë edhe faktin se i pandehuri ka bashkëpunuar me prokurorin e shtetit; se pranimin e fajësisë e ka bërë gjatë të gjitha fazave të procedurës penale; se i pandehuri është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale; se i njëjti ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale; se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale dhe se në kohën e kryerjes së veprës penale, i pandehuri ka qenë në një moshë të re.

#### 6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së kryetarit të trupit gjykues, dënimi me gjobë në shumë prej 400 € (katërqind Euro) ndaj të pandehurit N. C. duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Përveç këtyre, me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, kryetari i trupit gjykues e ka marrë për bazë edhe gjendjen pasurore të pandehurit.

Kryetari i trupit gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e saj; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 7. Dënimi me gjobë

Kryetari i trupit gjykues duke u bazuar në nenin 46 të KPRK, ka vendosur që nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do të barazohet me 20 (njëzet) Euro të dënimit me gjobë. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e të pandehurit, në vend të shqiptimit të dënimit me burgim, ta zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, ashtu

që 8 (tetë) orë të punës në dobi të përgjithshme do të llogariten me 20 (njëzet) Euro të dënimit me gjobë.

#### 8. Dënimi plotësues

Përveç dënimit kryesor, duke u bazuar në nenet 62, 69 dhe 374 paragrafi 3 të KPRK, ndaj të pandehurit N. C. shqiptohet edhe dënimi plotësues marrja – konfiksimi i armës së zjarrit – revoles e kalibrit 6 mm, e tipit ET-1081277.

#### 9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të akuzuarve, kryetari i trupit gjykues, duke u bazuar nënin 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar vetëm paushallin gjyqësor në shumë prej 25 Euro, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Krimeve të Rënda  
Më 9 shkurt 2016

Sekretarja juridike,  
Fikrete Destani

Kryetari i trupit gjykues,  
Afrim Shala

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi nuk mund të paraqitet ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, e as për shkak të vendimit për dënimin.